



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:059109

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05749730

KPPP.nr.1554/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.T.P. "Tosi" - F.U., me NRB:80461275, me seli në Pejë, rruga "F. Agani" nr.22, përfaqësuar sipas autorizimit nga Ndue Thaqi, avokat nga Prishtina, kundër debitorit Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me seli në Prishtinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga Avokatura Shtetërore, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.538/17 të datës 29.12.2017, të Përmbartuesit Privat Afet Mjeku, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 29.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.538/17 të datës 29.12.2017, të Përmbartuesit Privat Afet Mjeku.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.538/17 të datës 29.12.2017 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Afet Mjeku.
- III. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i personit të tretë N.P.SH. "Doni Term", i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.538/17 të datës 29.12.2017, të Përmbartuesit Privat Afet Mjeku.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit N.T.P. "Tosi" - F.U. , ka caktuar urdhrin P.nr.538/17 të datës 29.12.2017, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit

të besueshëm Faturës Nr. 02/11/15 të datës 09.11.2015, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që t'i paguaj kreditorit borxhin në shumë të përgjithshme prej 67,050.00 €, me kamatë ligjore prej 8 %, nga data e arritjes së kërkesës e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, me ndalimin dhe transferimin e të hollave në llogarinë e kreditorit, regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme deri në vlerën e borxhit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përbarimor duke theksuar se shuma e cila është cekur në faturën e cila është objekt i kësaj procedure përbarimore, nuk është cekur se cilat janë punët e kryera nga kreditori, në bazë të cilave është bërë faturimi sipas kësaj fature. Tutje ka shtuar se fatura si dokumenti i besueshëm duhet të jetë në origjinal, ndërsa e njëjta është bashkangjitur në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri përbarimor të shfuqizohet.

Kreditori në përgjigjen në prapësimin të paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim. Tutje ka theksuar se pretendimet e debitorit se në faturën e cila është objekt i kësaj procedure përbarimore nuk janë cekur punimet është e pabazuar për faktin se raporti për punët e kryera i është dorëzuar debitorit me kohë, ndërsa një kopje të këtij raporti e ka bashkangjitur me përgjigjen në prapësim. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri përbarimor të mbetet në fuqi.

Me datë 15.04.2019 N.P.SH. "Doni Term" përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur prapësim në cilësi të personit të tretë, duke pretenduar se ka të drejtë në një pjesë të shumës së borxhit, në bazë të Aktgjykimit IV.EK.nr.496/2015 të datës 01.11.2018, i nxjerr nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke shtuar se ky vendim është apeluar dhe se për të njëjtin ende nuk ka vendim nga Gjykata e Apelit e Kosovës. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit, ndërsa kreditorin ta udhëzojë në kontest civil për realizimin e të drejtës së tij.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PPP.nr.75/18, të datës 26.11.2020, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit, ka shfuqizuar urdhrin përbarimor, ka refuzuar si të pabazuar propozimin për përbarim të

kreditorit ndërsa personin e tretë N.P.SH. “Doni Term” e ka udhëzuar që të drejtën e tij ta realizojë në procedurë kontestimore.

Kreditori me datë 09.12.2020, ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Gjykatës së Apelit, që të aprovohet ankesa, ndërsa të anulohet aktvendimi i shkallës së parë dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr.377/22 të datës 08.05.2023, ka aprovuar si të themeltë ankesën e kreditorit, ka anuluar aktvendimin e atakuar dhe çështja i është kthyer Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata me datë 14.05.2024 ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore në të cilën kanë prezentuar përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit dhe ekonomisti i kompanisë, si dhe përfaqësuesi i autorizuar i debitorit, ndërsa përfaqësuesi i autorizuar i personit të tretë ka paraqitur pretendimet e tij përmes parashtrësës së datës 07.05.2024.

Përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit në seancën dëgjimore ka deklaruar se pajtohet me aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, ka shtuar se faturat nuk lëshohen pa u konfirmuar se janë kryer punimet andaj pretendimet e debitorit se punimet nuk janë kryer nuk qëndrojnë, e për këtë ka theksuar se ekziston ditari i punës i cili është pranuar nga ana e debitorit pa vërejtje dhe me nënshkrimin e tyre.

V.U. – Ekonomistë pranë kreditorit në seancën dëgjimore ka deklaruar se kreditori ka marr kredi pranë Bankës BPB, për blerjen e pajisjeve makinerike të cilat janë të faturuara në faturën e fundit dhe të dëshmuara me libra ndërtimor. Tutje ka shtuar se fatura e cila është objekt i kësaj procedure përmbarimore është obligim i kreditorit ndaj BPB-së për kredinë e marr, ndërsa sa i përket masës së sigurisë të personit të tretë N.P.SH. “Doni Term”, kjo masë është hequr me aktvendimin e datës 02.07.2015, ndërsa më vonë është hequr tërësisht, pala e trete ka iniciuar procedurat të cilat i takojnë e të cilat nuk lidhen me propozimin për përmbarim, përkatësisht nuk lidhet fare me faturën e cila është objekt i kësaj procedure përmbarimore, punimet që i ka kryer personi i tretë kreditori i ka paguar 1-2 vite para shkëputjes së kontratës, e cila është vërtetuar

edhe nga vendimi i gjykatës për heqjen e masës së sigurisë në vitin 2016. Krejt në fund ka shtuar se fatura objekt i kësaj çështje përmbartimore është obligim i debitorit ndaj kreditorit, ndërsa kreditori ka obligim ndaj bankës BPB.

I autorizuari i debitorit në seancën dëgjimore ka deklaruar se sipas vendimit për shkëputjen e kontratës shuma e papaguar ndaj kreditorit është shuma 117,310.38 €, ndërsa shuma sipas faturës është më e ulët, edhe në rast se shumës sipas faturës i shtohet vlera prej 37,391.20 €, për të cilën kreditori ka deklaruar se do të inicioj procedurë të veçantë, përsëri ka mospërputhje mes shumave. Tutje ka shtuar se fatura është lëshuar mbi bazën e një kontrate e cila është shkëputur paraprakisht, ndërsa punët të cilat janë faturuar të njëjtat nuk janë përfunduar, po ashtu ka shtuar se nuk e konteston faktin se shuma e mbetur pa paguar ndaj kreditorit është 117,310.38, kjo është e sqaruar edhe në vendimin për shkëputjen e kontratës, e po në të njëjtin vendim janë dhënë edhe arsyet e se pse nuk janë paguar. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbartimor ta shfuqizoj.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, deklarimeve në seancën dëgjimore, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërejtjeve sipas aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69, 71 dhe 75 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit dhe prapësimi i personit të tretë janë të pabazuar, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr. 02/11/15 e datës 09.11.2015, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm, i përmban të gjitha elementet e kërkuara dhe është e përshtatshme për përmbartim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit

1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - Faturën Nr. 02/11/15 e datës 09.11.2015, e cila faturë i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet, si dhe është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal, si dhe është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori.

Në rastin konkret rezulton se Fatura Nr. 02/11/15, në vlerë prej 67,050.00 €, është lëshuar nga ana e kreditorit me datën 09.11.2015 dhe e njëjta është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori e cila evidentohet përmes vulës së protokollit Nr. 3040 të datës 10.11.2015.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përbarimi.

Sa i përket prapësimit të personit të tretë, gjykata iu referua dispozitave të nenit 75 par.1 të LPP-së me të cilin është përcaktuar se: *“Një person tjetër nga debitori që pretendon se ka të drejtën lidhur me objektin e përbarimit që nuk është në pajtim me përbarimin e atij objekti mund ta paraqes prapësimin kundër përbarimit, me kërkesë që përbarimi për objektin e përbarimit të shpallet i palejueshëm në pjesën me të cilën është përfshirë e drejta e tij”*, dhe nenin 76 par.3 të LPP-së, me të cilin është përcaktuar se: *“Kur përbarimi është zbatuar nga përbaruesi privat, Gjykata me juridiksionin përkatës siç është përcaktuar në paragrafin 5. neni 5 të këtij ligji do të vendosë për prapësimin”* dhe par. 4 të të njëjtit nen me të cilin përcaktohet: *“Gjykata do të vendosë për prapësimin e personit të tretë në procedurë të përbarimit sa herë që një gjë të tillë e lejojnë rrethanat e rastit konkret, e sidomos kur parashtruesi i prapësimit e*

*provon themelësinë e prapësimit të tij me anë të aktgjykimit të formës së prerë, me anë të dokumentit publik, ose me anë të dokumentit jo-publik të certifikuar sipas ligjit.”*

Bazuar në dispozitën e lartcekur, rezulton se në mënyrë që një prapësim i palës së tretë të rezultojë si i bazuar, pala duhet që të provojë ekzistimin e një interesi pronësor në objektin e përmbarimit përmes aktgjykimit të formës së prerë, dokumentit publik, ose përmes dokumentit jo-publik të certifikuar sipas ligjit.

Në rastin konkret, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.nr.496/15, me të cilin është vendosur sipas kërkesëpadisë së paditësit (personit të tretë) N.P.SH. “Doni Term”, ndaj të paditurit këtu kreditorit N.T.P. “Tosi” - F.U., nuk paraqet provë mbi bazën e të cilës vërtetohet se e drejta e tij është e përfshirë në objektin e përmbarimit, sepse vendimi përcakton detyrimet e të paditurit në raport me paditësin, mirëpo nuk mund të shërbejë si bazë për ndalimin e kreditorit për përmbarimin e kërkesës së tij ndaj palëve tjera, përkatësisht ndalimin e realizimit të të drejtave të tij në raport me personat tjerë, e për më tepër i njëjti nuk paraqet vendim të formës së prerë nga i cili do të provohej themelësia e prapësimit të paraqitur nga personi i tretë.

Në këtë drejtim, meqenëse procedura përmbarimore i nënshtrohet parimit rigoroz formal, shpallja e palejueshëm e objektit të përmbarimit është i kufizuar shprehimisht nga shkaqet e përcaktuara me nenin 75 të saj, e të cilat shkaqe nuk përmbarohen në rastin konkret.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1554/23, datë 29.05.2024

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.